

# LIDHËS U

*Shtesë polimeri për përmirësimin e ngjitjes, elasticitetit dhe rezistencës ndaj ujit në përzierjet e llaçit*

## FUSHA E APLIKIMIT

Për përmirësimin e veçorive fizike të përzierjeve të çimentos. Aplikohet gjatë përpunimit të dyshemeve dhe hibercugut("këmishëz"), gjatë reparacioneve të betoneve dhe llaçeve, te shtresat e çimentos dhe llyerësve për përmirësimin e veçorive ngjitëse të llaçeve për ngjitjen e pllakave qeramike dhe të tjera.

Për stabilizim dhe impregnim sipërfaqësor te bazat (dyshemetë) nga çimentoja.

Për përpunimin e prajmerëve(llyerësve paraprakë) për përmirësimin e lidhjes midis betonit(laçit) të vjetër dhe të ri gjatë hedhjes së përzierjeve të çimentos.

## CILËSITË

- Përmirësimin e veçorive ngjitëse dhe lehtësimin e futjes së llaçeve nga çimentoja në ndërtim
- Përmirësimin e përpunimit të përzierjes së freskët të çimentos
- Shtimin e rezistencës ndaj ndikimit atmosferike, veçanërisht gjatë cikleve të ngrirjes
- Nuk përmban kloride

## VEÇORITË TEKNIKE

VEÇORI	METODË	VLERA E DEKLARUAR
Pamja	/	Lëng I bardhë
Dendësia	ISO 758	1,03 ± 0,03 g/cm <sup>3</sup>
pH vlera	ISO 4316	7,0 - 9,0

## APLIKIMI SI LYERËS

### PËRGATITJA E BAZËS

Gjatë reparacionit ose stabilizimit të sipërfaqeve të betonit, baza që riparohet(meremetohet) duhet të jetë e pastër, pa pluhur dhe pa yndyrë. Është e nevojshme të mënjanohe mbeturinat e bojës, llaçit, yndyrës, bimëve etj. Në qoftë se materiali hidhet mbi bazë të lëmuar dhe të shëndoshë, është e preferueshme që sipërfaqja të bëhet e vrazhdë me anë të furçës me fije çeliku. Bazat e përgatitura në këtë mënyrë, duhet të lagen me ujë deri në shkallë të ngopjes. Nëse në bazë shfaqet armatura, ajo duhet të pastrohet deri në shkëlqim të metalit(me anë të furçës me fije çeliku ose me anë të rërës së imtë) dhe të mbrohet me Reparatur Penetrat ose Antikoroazin E.

### PËR STABILIZIM/IMPREGNIM TË BAZAVE TË ÇIMENTOS

Materiali përgatitet me përzierje në proporcionin: Lidhëse U: Ujë = 1 : 2. Përzierja e përgatitur në këtë mënyrë futet në bazë me anë të furçës në një shtresë. Nëse sipërfaqja bazë është tejet poroze, nevojitet hedhja e shtresës së dytë. Baza e trajtuar në këtë mënyrë fiton nuancë më të errët.

### SI PRAJMER(LYERËS PARAPRAK) PËR LLAÇ DHE BETON

Shtresa bazë prajmerohet me përzierje (Lidhëse U : Ujë) në përpjesëtimin 1 : 3 ose 1 : 4. Prajmeri i përgatitur në këtë mënyrë, hidhet në bazë me furçë. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet hedhjes së llaçit të ri ose betonit me prajmer të posapërgatitur, gjegjësisht 20 deri 30 minuta pas hedhjes së prajmerit. Nëse prajmeri është i tharë, duhet që ai të mënjanohet në mënyrë mekanike dhe baza të prajmerohet përsëri.

## APLIKIMI SI ADITIV PËR LLAÇ DHE BETON

Dozimi optimal i Lidhësit U është 3% - 7% në masën e çimentos. Lidhësi U i shtohet ujit për përgatitjen e llaçit dhe përzihet mirë. Pjesa e lëngshme e përgatitur në këtë mënyrë i shtohet pjesës së masës në pluhur. Disa orë të para pas futjes në ndërtim të përzierjes së llaçit, duhet të ndërmerren masa përkatëse për mbrojtjen dhe përkujdesjen e betonit të sapo përgatitur, siç është pengimi i ekspozimit direkt të rrezeve të diellit apo erës, pengimi nga ekspozimi në temperatura të larta dhe spërkatja me ujë.

## EFKTET NGA MBIDOZIMI

Gjatë mbidozimit të aditivit ekziston rreziku nga vonimi i theksuar i fillimit dhe fundit të lidhjes te betoni ose llaçi. Ky efekt është më i theksuar gjatë përdorimit çimentos së rezistueshme ndaj sulfateve ose të portland-çimentos me substanca shtesë(aditivë).

## PASTRIMI

Veglat dhe pajisjet menjëherë pas përdorimit pastrohen me ujë të pastër.

## KOMPATIBILITETI

Lidhësi U është kompatibel me shumë aditivë nga programi i ADING-ut. Në qoftë se në përzierjen e llaçit përdoren dy ose më tepër aditivë, duhet që të bëhen prova paraprake. Aditivët e ndryshëm dozohen në veçanti, gjegjësisht përzihen mes vete para se të hidhen në masën e çimentos.

Lidhësi U është i përdorshëm me të gjitha llojet e portland-çimentos, çimentos së rezistueshme ndaj sulfateve dhe çimentos me hi përhapës ("fluturues").

## PAKETIMI

Kanta plastike: 1, 5 и 20 kg

Kontejnerë: 1000 kg

## RUAJTJA

Në paketim origjinal në temperaturë 5°C deri 35°C dhe të mbrojtur nga ndikimi i drejtpërdrejtë i rrezeve të diellit.

Afati i përdorimit: 12 muaj.

Rreziku për shëndetin: Lidhësi U nuk përmban materie toksike, por, me gjithë këtë, duhet pasur kujdes që materiali të mos vijë në kontakt me lëkurën, sytë ose të mos gjëllitet. Në rast të kontaktit me lëkurën ose sytë, ato duhet të shpërlahen me ujë të rrjedhshëm. Nëse gjëllitet, menjëherë duhet të kërkohet ndihmë mjekësore. Informata plotësuese janë dhënë në Certifikatin e sigurisë së prodhimit.

Zjarri: Lidhësi U është lëng që nuk ndizet. Informacione plotësuese janë dhënë në Certifikatin e sigurisë së prodhimit.

Pastrimi dhe deponimi: Mbeturinat e Lidhësit pastrohen me ujë. Ambalazha e vjetër e përdorur duhet të deponohet sipas rregullativës ligjore lokale për këtë lloj të prodhimit. Informacione plotësuese janë dhënë në Certifikatin e sigurisë së prodhimit.